Buletini VI, Dhjetor, 2018

Dita Ndërkombëtare e Vullnetarëve

Më 5 dhjetor 2018, në kuadër të projektit EDI 2, i financuar nga Agjencia Austriake për Zhvillim (ADA), Dita Ndërkombëtare e Vullnetarëve 2018 u festua në Termokiss. Vullnetarët dhe stafi i tre organizatave partnere (Balkan Sunflowers, The Ideas Partnership, Play International) ishin të ftuar në koktej, ku patën mundësinë të luajnë lojëra të ndryshme (lojëra me letra, shigjetat dhe ping-pong), ndërveprojnë me njëri-tjetrin dhe gjithashtu marrin pjesë në seancën karaoke.

Ky koktej u organizua për të festuar kontributin e çmuar të vullnetarëve tanë në punën tonë me komunitetet Romë, Ashkali, Egjiptian, Boshnjak e Kroat në tri komuna të ndryshme në Kosovë, dhe për të promovuar vullnetarizmin në Kosovë. Organizatat partnere vlerësojnë lart punën e më shumë se 100 vullnetarëve vendor dhe ndërkombëtar që na ndihmojnë çdo ditë në misionin tonë për përmirësimin e jetës së fëmijëve dhe familjeve me të cilat ne punojmë.

Tryeza me temën "Ofrimi i shërbimeve shëndetësore nga QKMF

Me 12 dhjetor, Balkan Sunflowers Kosova (BSFK) dhe Qendra Kryesore e Mjekësis Familjare (QKMF) në Fushë Kosova kanë organizuar në Prishtinë tryezën me temën "Ofrimi i shërbimeve shëndetësore nga QKMF krahasuar me ndryshimin e numrit të banorëve në Fushë Kosovë".

Pjesëmarrës ishin përfaqësues nga: Divizioni për Kujdes Parësor Shëndetësor nga Ministria e Shëndetësis, Drejtoria e Shëndetësis dhe mirëqenjes Sociale (Fushe Kosovë), Zv. Ministri i Ministrisë për Komunitete dhe Kthim, Drejtori i QKMF së bashku me Kryeshefin e Shërbimeve Mjekësore dhe me Shefin e Shërbimeve të Mjekësis Familjare, zyrtar të Zyrës për Punë dhe Mirëqenje Sociale, Kryetari i sindikatës së mjekëve në Fushë Kosovë, partner implementues nga OJQ, dhe donatorin Solidare Suisse Kosova, si dhe përfaqësues nga Klubi Rinor në Fushë Kosovë.

Në tryezë u diskutua ofrimi i shërbimeve mjekësore që nga viti 2010 deri më sot. QKMF dhe BSFK prezantuan të gjeturat nga statistikat të cilat tregojnë që numri i vizitave mjekësore në vitin 2017 në krahasim me vitin 2010 është ngritur për 67%. Në anën tjetër, ofrimi i shërbimeve mjekësore është ngritur për 114%.

Bazuar në regjistrimin e popullësis në vitin 2011 në Fushë Kosovë në vitin 2011 kanë jetuar 34827 banorë.

Nëse marrim ngritjen mesatare të dy përqindjeve, mund të përllogaritim se numri i banorëve në Komunë të Fushë Kosovës është ngritur nga 34827 në 66379 banorë.

Komuna e Fushë Kosovës lejohet të punësoj 104 punëtorë shëndetësor që nga viti 2011. Ky numër nuk ka ndryshuar që nga viti 2011 edhe pse numri i banorëve është ngritur 67% - 114% që nga viti 2011.

Pjesëmarrësit janë pajtuar që të punohet së bashku në realizimin e rekomandimeve të poshtëshënuara:

- Rritjen e numrit të stafit mjekësor
- Përmirësimin e infrastrukturës
- Freskim të aparaturës mjekësore
- Sigurimit të autoambulancës
- Sigurimi i hapësirave adekuate aparatur për shërbime specialistike
- Strukturim të bashkëpunimit në mes të akterë ve të ndryshëm që veprojnë në Komunë të Fushë Kosovës.

Shkollimi i mohuar – reportazh i relaizuar nga KTV për nxënësit e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian.

Edhe pse fëmijët dëshirojnë të jenë të barabartë me fëmijët e tjerë dhe të ndjekin mësimin me bashkëmoshatarët e tyre, kushtet e rënda ekonomike i pamundësojnë familjes që të dërgojë fëmijët në shkollë, dhe njëkohësisht për të mbijetuar ata shësin kanaqe.

Një arsye tjetër pse fëmijët nuk shkojnë në shkollë, është edhe mungesa e dokumentacionit.

Problem tjetër është edhe braktisja e mësimit nga nxënësit e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian. Gjatë 2017 sipas masht 228 kanë braktisuar shkollimin fillor, për arsye të ndryshme. Z. Ali Topalli, zëdhënës i komunës së Fushë Kosovës, thotë që sistemi edukativ në Fushë Kosovë është i hapur dhe i njëjtë për të gjitha komunitetet. Sa i përket braktisjes, ai thotë së në Fushë Kosovë janë dy klasa të vecanta për fëmijët që kanë braktis mësimin dhe rikthehen. Edhe pse akoma ka braktisje nga nxënësit e këtyre komuniteteve, z. Topalli thot se ka përmirësim.

Menaxheri i Programit të Qendrave për Mësim-nxënie në Balkan Sunflowers Kosova, Z. Samir Shahini spjegon arsyet e braktisjes së shkollimit të fëmijeve në Kosovë, me theks të veqant të fëmijëve Rom, Egjiptian, dhe Ashkali, për Emisionin Cosmo në Kohavision. Z. Shahini thekson se mësimi braktiset më shumë nga nxënëset të gjinisë femërore. Z. Shahini mendon që arsyeja kryesore për braktisje është trajtimi jo i barabartë nga të tjerët dhe diskriminimi etnik. Gjithashtu arsye është faktori social dhe familjar, ku prindërit nuk i shtyejnë dhe motivojë fëmijët të ndjekin mësimin për shkak mungesës së informatës nga prindërit për rëndësinë e mësimit. Rreziku në shkollë, ku ka fëmijë që janë ngacmu apo edhe bulizmi ndaj nxënësve. Fatkeqësi e madhe është, që diskriminimi i ndodh edhe nga vetë mësimdhënësit në klasa.

Drejtoresha e shkollës "Selman Riza" Znj. Remzije Bugujevci, thotë së prindërit e fëmijëve nuk interesohen për vijimin e nxënësve në shkollë, dhe kjo ju shkakton problem pasi ka shumë mungesa të fëmijëve. Sipas saj, braktisja e shkollës është më së shumti për shkak kushteve të rënda ekonomike. Për të përmirësuar gjendjen, shkolla bashkëpunon me mediatorë të OJQ-ve për t'i informuar se ka fëmijë që kanë munguar, dhe mundohen t'i rikthjenë në shkollë.

Z. Rinor Qehaja, thotë së ngritja e vetëdijes tek këto komunitete duhet të jetë me e lartë për rëndësine e shkollimit, dhe kjo të bëhet në mënyrë institucionale, të jetë prioritet i MASHT- qeverisë. Praktika më e mirë është përfshirja e fëmijëve në edukim që nga shkollimi parashkollor.

Si përfundim, yë gjithë fëmijët duhet ta gëzojnë barabartë së paku shkollimin fillor sic edhe parashihet në Kushtetutën e Kosovës.

https://www.youtube.com/watch?v=qdEyxbaZ2A0&feature=youtu.be&fbclid=IwAR2Aa34Iariep-

Vizita në Janjevë e zyrtarëve komunal të Lipjanit

Gjatë muajit dhjetor, TIP pati mundësine të mirëpres në qendrën e tyre në Janjevë z. Lulzim Qerimin, Nënkryetar për Komunitete në Komunën e Lipjanit, si dhe z. Bekim Shabani, Drejtor për Kulturë, Rini dhe Sport në këtë komunë. Ata u mirëpritën nga koordinatori i qendrës në Janjevë, Shkëlqim Bahtiri, dhe edukatorja e kopshtit, Majlinda Krasniqi, të cilët i njoftuan me punën e tyre në Janjevë dhe angazhimin qe TIP ka të vazhdueshëm në ofrimin e mundësive të shkollimit dhe shëndetësisë për të gjitha komunitetet që jetojnë atje. Qendra e TIP në Janjevë ofron aktivitete falas çdo ditë për fëmijët parashkollorë, aktivitete jashtëshkollore për fëmijët deri në 15 vjeç, klasa të shkrim-leximit për nënat, klasa të shëndetësisë etj.

Shkëmbim përvojash me organizatën Help the Life

Anëtarë të stafit te disa organizatave nga Kosova, pwrfshirw Balkan Sunflowers Kosova, The Ideas Partnership, dhe Play International, kanw qenë pjesë e vizitës studimore në organizatën Help the Life Association në Tiranë, Shqipëri. |

Stafi i projektit EDI 2 shkëmbyen përvojat dhe praktikat më të mira në lidhje me gjithëpërfshirjen dhe ofrimin e mundësive të barabarta të shkollimit për personat me nevoja të veçanta në qendrat tona. Kjo vizitë u realizua në kuadër të projektit EDI 2, i financuar nga Agjencia Austriake për Zhvillim (ADA).

Përmirësimi i kushteve të banimit grupeve të cenuara në katër Komuna të Kosovës

Gjatë vitit 2018, VoRAE, ka arritur të perfundoj me sukses projektin për përmirësimin e kushteve të banimit për 72 familje të komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian si dhe grupeve te tjera të cenuara në katër Komuna sic janë Lipjani, Klina, Fushë Kosova dhe Prizreni.

Gjatë vitit në këto komuna janë ndërtuar shtëpi të kater modeleve me hapsira të banimit 60m2, 42m2, 27m2 dhe banjos max. 5m2 nga themeli, si dhe renovimet në pjesët tjera të shtëpive të cilat realizohen në bashkëpunim me familjet përfituese.

Implementimi i këtij programi nga VoRAE është bërë i mundshëm në bashkëpunim me partneret dhe donatorët tonë nga HEKS-i dhe SDC-ja Komunat përfituese, si dhe me mbështetjen profesionale nga kompania konsulente nga Zvicra në fushën e banimit (SKAT).

Është shumë e rëndesishme të theksohet se programi është cost-effective.

Kjo do të thotë se programi bëhet në bashkëpunim të ngushtë me përfituesin e projektit i cili është pronar i shtepisë/ tokës ekzistuese.

Projekti për përmirësimin e kushteve të banimit do të vazhdojë të implementohet edhe gjatë vitit 2019 në 4 komuna të cilat janë të gatshme të bashkëpunojnë/ bashkfinancojnë programin e VoRAE.

Fushatë avokuese në fshatin Cigë

Pejë/19 Dhjetor. Identifikimi, adresimi dhe kërkimi i mundësive për zgjidhjen e nevojave primare të familjeve – ishte qëllimi i takimit të sotëm avokues me familjet e komuniteteve të ndryshme të fshatit Cigë, përfaqësuesin e bashkësisë territoriale dhe mësimdhënësit e shkollës së këtij fshati, ndërsa me këtë takim përmbyllet për këtë vit cikli i fushatave avokuese me komunitetin.

Vlen të theksohet se në kuadër të projektit "Mbështetje në Integrim dhe Fuqizim për të kthyerit Romë, Egjiptianë dhe Ashkalinjë përmes zhvillimit të Kapaciteteve në Arsimin Fillor në Kosovë" i cili implementohet nga Syri i Vizionit dhe mbështetet nga GIZ-i, gjatë vitit 2018 janë realizuar 18 fushata avokuese me komunitetin përmes të cilave janë arritur më shumë se 300 persona, kryesisht nga komunitetet romë, egjiptianë dhe ashkalinjë. Synimi i përgjithshëm i këtyre fushatave është përmirësimi i mundësive dhe i kushteve të gjithëmbarshme sociale dhe ekonomike të komuniteteve që jetojnë në 6 lokalitetet në të cilat zhvillohet projekti në fjalë, me theks të vecantë te aspekti edukativ dhe mësimor i fëmijëve dhe i familjeve të tyre. Me angazhimin e familjeve, fëmijëve, mësimdhënësve të shkollave, zyrtarëve të institucioneve lokale dhe përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile, janë identifikuar nevojat dhe problemet kryesore të sferave sociale, edukative dhe ekonomike të komuniteteve dhe të shkollave fillore të 6 lokaliteteve të ndryshme të komunës së Pejës, Klinës dhe Istogut, dhe si rrjedhojë janë aktivizuar përpjekjet dhe resurset e ndryshme për zgjidhjen e tyre, para së gjithash me ndihmën e institucioneve lokale dhe publike si edhe të akterëve tjerë të përfshirë në këtë proces.

Kontrolla mjekësore në komunitet

13 dhjetor 2018 – Lagja 7 Shtatori Pejë. Syri i Vizionit në kuadër të projektit "PROSPECT+" ka organizuar kontrolleve mjekësore tek familjet e komuniteteve Romë, Egjiptian dhe Ashkalinjë. Këto kontrolle mjekësore kanë për qëllim vetëdijesimin e familjeve të komuniteteve për kujdesje ndaj shëndetit dhe vizita më të shpeshta shëndetësore në qendrat e mjekësisë familjare. Përveç matjes së tensionit, sheqeri janë dhëne edhe këshilla mjekësore për parandalimin e gripave sezonal.

Tryezë e Rrumbullakët rreth zbatimit të Strategjisë në Klinë

Klinë/21 Dhjetor – Tryezë e Rrumbullakët rreth zbatimit të Strategjisë për përfshirjen e komuniteteve Romë dhe Ashkalinjë në shoqërinë kosovare. Me pjesëmarrjen e Drejtorit të Arsimit të Komunës së Klinës, zyrtarit nga Zyra komunale për Kthim dhe Komunitete, drejtorët dhe mësimdhënësit e shkollave fillore “Ismet Raci” dhe “Motrat Qiriazi” si dhe zyrtarët e Qendrës për Punë Sociale, u diskutua rreth progresit në zbatimin e Strategjisë në territorin e komunës së Klinës, në mënyrë specifike në sektorin arsimor dhe atë social.

Dita Universale e Fëmijëve

RADC organizoi një program artistik për Ditën Universale të Fëmijëve. Programi u prezantua me pothuajse 60 fëmijë nga komunitetet rom, ashkalinj dhe egjiptian dhe 10 fwmijw nga komunitetet të tjera pakicw (boshnjake dhe turke) ku performuan vepra të ndryshme si: poezi, këngë, valle dhe madje edhe skena drame!

Ky program artistik u zhvillua në Qendrën Kulturore "Rexhep Mitrovica" në Mitrovicë, ndërsa prezent ishte edhe nënkryetari i komunës së Mitrovicës, z. Faruk Muja, së bashku me përfaqësuesin e OSBE dhe DRC.

Parandalimi i braktisjes së shkollës

Nevo Koncepti në bashkëpunim me zyrtare të kuvendit komunal në Suharekë janë kontaktuar për një rast i cili ka të bejë me braktisje të shkollës nga fëmijët e një familje, andaj Nevo Koncepti së bashku me DKA kanë zhvilluar vizitat në teren.

Andaj, me datën 21.12.2018 në komunën e Suharekës, stafi i Nevo Konceptit në bashkëpunim me zyrtar të kuvendit komunal në Suharekë kanë vizituar familjen në lidhje me parandalimin e braktisjes së shkollës nga fëmijët.

Gjithashtu, është intervenuar dhe së bashku me prinder është biseduar për të mirat dhe pse fëmija duhet të vazhdojë të vijoj mësimet me rregull.

Ky aktivitet është realizuar në kuadër të projektit PROSPEKT +, që financohet nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri të Hapur (KFOS) me mbështetjen e Qeverisë Gjermane dhe Fondacionit Gjerman Karl Kübel Stiftung für Kind und Familie (KKS). Projekti zbatohet në Komunën e Suharekës dhe ka për qëllim të kontribuojë në zbutjen e varfërisë dhe realizimin e të drejtave të komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë.

Ligjerata për paragjykimet dhe steriotipet

Me 18 dhjetor, në asmblen e komunës të Suharekës është mbajtur ligjerata për paragjykimet dhe steriotipet.

Në aktivitet kanë qenë të përfshirë nxënësit e shkollave të mesme dhe nxënes të shkollave fillore te komunës së Suharekës, si dhe pjesë e këtij aktiviteti ishin edhe fëmijet e komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian.

Qëllimi i aktivitetit ishte eliminimi dhe parandalimi i paragjykimeve dhe steriotipeve për fëmijet rom, ashkali dhe egjiptpan.

Në kuadër të projektit "Promovimi i Intergrimit të Komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian në komunën e Suharekës është mbajtur ligjeratë në bashkëpunim me Drejtorinë e Kulturës Rinisë dhe Sporteve në Suharekë dhe OSCE.

Punëtoria me temën “dhuna në baza gjinore dhe dhuna në familje”

Me datën 18 dhjetor 2018 është mbajtur punëtoria me temën dhuna në baza gjinore dhe dhuna në familje me të rinjtë dhe përfaqësuesit e komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian nga Komuna e Deçanit.

Ky aktivitet është pjesë e projektit “Ngritja e vetëdijes për të rinjtë Romë, Ashkali dhe Egjiptianë mbi mekanizmat ligjorë kundër dhunës në baza gjinore dhe parandalimin e fenomeneve të DHBGJ-së” në komunat e Istogut, Pejës, Klinës dhe Deçanit, që realizohet me ndihmën e Programit për Angazhimi për Barazi - E4E, financuar nga Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndëkombëtar - USAID dhe zbatuar nga Qendra e Trajnimeve dhe Burimeve për Avokim – ATRC

Ligjerata mbi të drejtat e fëmijëve dhe dhunës në baza gjinore në familje

Me 11 dhejtor, 2018 është mbajtur ligjerata mbi të drejtat e fëmijëve dhe dhunës në baza gjinore në familje, në SH.F.M.U “Ismet Raci” dhe SH.F.M.U “Motrat Qiriazi”ne Komunën e Klinës.

Ky projektit realizohet nga RROGRAEK me ndihmën e Programit për Angazhim për Barazi – E4E, financuar nga Agjencia e Shteteve SHBA-ve-USAID, dhe përkrahur nga Qendra për Trajnime, Avokim dhe Burime – ATRC

"Fletënotimet komunitare"

Më datë 10 dhjetor 2018 u mbajt takimi ballë për ballë i fazës së katërt të procesit "Fletënotimet komunitare" më SH.F.M.U. "Anton Z. Cajupi" Mitrovicë. Në këtë takimi u krijua plani i veprimit për realizimin e tij në vitin 2019. Ky aktivitet u realizua në kuadër të projektit "Mobilizimi i komunitetit mbi llogaridhënjën sociale" në partneritet me Save the Children dhe financuar nga SPL.

"Martesat e hershme”

Me 06 Dhjetor 2018, u mbajt takimi me OJQ dhe mekanizma komunal, me temë "Martesat e hershme". Takimi u organizua në vazhdën e "16 Ditë aktivitete kundër dhunës ndaj grave", në kuadër të projektit 'Parandalimi i martesave të hershme të komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptiane të Kosovës. Ky takim është implementuar nga RROGRAEK, mbështetur nga UN Ëomen dhe financuar nga BE.

"Edukimi për TIK i të rinjve”

Me 21 dhe 22 dhjetor 2018, në Gjurkoc dhe Shtime filluan aktivitetet e para të projektit "Edukimi për TIK i të rinjve të komuniteteve Ashkali, Egjiptian dhe Rom", ku para të rinjve të fshatit Gjurkoc - Shtime prezantuam projektin në fjalë dhe diskutuam për përdorimin e internetit në mënyrë të duhur dhe rëndësin e përdorimit të programeve të Microsoft office.

Të rinjët e mirëpriten projektin dhe theksuan se ka qenë shumë e nevojshme për të rinjët tonë një projekt i tillë.

Projekti implementohet nga OJQ BRAN - Bashkimi Rinor E Ardhmja E Ndritur dhe është mbështetur nga Ministria e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë.

Mirënjohje për OJQ BRAN nga Komuna e Ferizaj

Me 31 Dhjetor 2018, në Ferizaj OJQ BRAN, pranoi një Mirënjohje nga znj.Xhemile Murati-Shabani - Drejtoresh e Kulturës, Rinisë dhe Sportit në komunën e Ferizajit.
Mirënjohja u nda nga DKRS-ja për angazhimin, bashkëpunimin dhe zhvillimin e aktiviteteve rinore dhe kulturore të OJQ BRAN gjatë vitit 2018.
OJQ BRAN beson që me përkrahjen e partnerëve dhe angazhimin tonë, gjatë vitit 2019 do të zhvillojmë edhe më shumë aktivitete rinore, sportive dhe kulturore për të rinjët e të gjitha komuniteteve në regjionin e Ferizajit dhe më gjerë.
BRAN vlerëson lartë punën e stafiit, anëtarëve dhe vullnetarëve të tyre dhe të gjithë bashkëpuntorëve për kontributin e tyre gjatë këtij viti sepse pa ndihmën dhe përkrahjen e tyre nuk do të arrinin këto suksese si organizatë.

Shpërndarja e dhuratave për vitin e ri

Podujevë, 20 dhjetor 2018: Në kuadër të projektit “Përmirësimi i qasjes dhe (ri)integrimit në arsimin bazë të fëmijëve dhe familjeve migrante dhe të kthyer në Kosovë”, financuar nga GIZ CDBE dhe zbatuar nga Tdh, me rastit e festave të fundvitit, rreth 20 fëmijë të Klasës së Mësimit Shtesë në shkollën fillore “Enver Maloku” të komunës së Podujevës vizituan shokët dhe shoqet e tyre nga Qendra “Autizmi” në Podujevë, të cilëve ju shpërndanë dhuratat e vitit të ri të përgatitura nga vetë ata. Ata kanë kaluar dy ditë të tëra duke bërë gati dhuratat për bashkëmoshatarët e tyre me plot dashuri dhe zell.
Për më tepër, fëmijët e kësaj klase shfaqën para prindërve programin festiv të përgatitur paraprakisht, në fund të së cilit fituan edhe dhurata nga ky projekt.

Ngritja e kapacitetëve të profesionistëve në fushën e mbrojtjës së fëmijës

Prishtinë, 13.12.2018: Në kuader të projektit "Rrjeti i Sigurt për Mbrojtjen e Fëmijeve - Faza III", financuar nga Fondacioni MEDICOR implementuar nga Terre des hommes në Kosove (Tdh), me qëllim të ngritjës së kapacitetëve të profesionistëve në fushën e mbrojtjës së fëmijës, është mbajtur Punëtoria: Përdorimi i protokollit të punës: Puna Ndërsektoriale në Mbrojtje të Fëmijëve (TMR) në Komunat Dragash, Novoberdë, Kllokot, Malishevë dhe Mamush.". Pjesëmarrës ishin profesionist nga Institucione si: Punëtori Social nga Qendra për Pune Social QPS, Zyrtar nga Drejtoria Komunale e Arsimit DKA, Zyrtar nga Policia e Kosovës, Zyrtar nga zyra për komunitete dhe kthim ZKK.

Kjo punëtori është lehtësuar nga Agron Seferi dhe Naim Bilalli, Menaxher të rastëve në Tdh